



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, **për 2 (dy) vende të lira** në pozicionin:

1. Specialist në Drejtorinë Juridike pranë KMD-së- Kategoria: IV-1

Pozicioni i më sipërmë, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

20.09.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

25.09.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Sigurimi i respektimit të kuadrit ligjor dhe cilësisë së hartimit të akteve juridike.
2. Jep këshillim juridik dhe ekspertizë në përpunimin e teksteve normative.
3. Përfaqëson institucionin në grupet e punës të fushës juridike.
4. Përfaqëson institucionin në të gjitha çështjet gjyqësore ku është i përfshirë institucioni.
5. Jep mendim të specializuar lidhur me çështje të ndryshme ligjore të institucionit.
6. Përgatit mendime juridike në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi për akte ligjore e nënligjore të ardhura nga institucione të tjera, me qëllim implementimin në to të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi si dhe për të gjitha aktet e prodhuara nga Institucionin e Komisionerit.
7. Përgatit informacione, relacione, dokumenta, raporte dhe monitorime që lidhen me ushtrimin e detyrave të tij.
8. Ndjek procedurën për ekzekutimin e vendimeve me gjobë të përcjella nga Drejtoria Hetimit Administrativ.
9. Merr pjesë në seancat dëgjimore publike që zhvillohen nga Komisioneri ku ftohen palët dhe çdo person tjetër i interesuar në çështjet e ngritura për shqyrtim dhe mban procesverbalin e seancës.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi; (të vërtetuar me një dokument nga institucioni)
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”.

ç- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional ose Shkencor” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë; *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

c- Preferohet me përvojë punë të përfaqësimit të çështjeve në institucionet shtetërore dhe gjyqësore.

d - Preferohet të disponojë licensën e Avokatisë.

e - Të ketë njohuri të gjuhës angleze përbën avantazh edhe njohja e një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).

f - Të ketë aftësi për të punuar në grup;

g- Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet bazë të kompjuterit.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit ; (Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar)

c - Fotokopje të listës së notave

d - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose vërtetime të eksperiencave të punës si jurist/e.

e - Certifikatë gjuhe të huaj

ë - Licencën e Avokatisë (*nëse e dispononi*)

f - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

g - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

gj - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

h - Vlerësimin fundit nga eprori direkt;

i- Aktin e emërimit si nëpunës civil;

j - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

k - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

l. Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-ivetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>

Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara.

Mosparaqitja e dokumentacionit përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: Rruga "Durrësit", Nr.27, Tiranë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 20.09.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22.09.2026**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të KMD-së, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afateve të ankimimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligji nr. 214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2021 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj;
- Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:
Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i vënë për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komisionin e Brendshëm për Lëvizjen paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (www.kmd.al) dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

2.1**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a -Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Profesional ose Shkencor " në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);*
- b- Preferohet me përvojë punë të përfaqësimit të çështjeve në institucionet shtetërore dhe gjyqësore;
- c- Preferohet të disponojë licencën e Avokatisë;
- d- Të ketë njohuri të gjuhës angleze përbën avantazh njohja e një gjuhe kryesore të BE-së (frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
- e- Të ketë aftësi për të punuar në grup;
- f- Të njohë dhe përdorë shumë mirë programet bazë të kompjuterit.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit; (Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar).

c- Fotokopje të listës së notave.

d - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose vërtetime të eksperiencave të punës si jurist/e.

e- Certifikatë gjuhe të huaj.

ë- Licencën e Avokatisë (*nëse e dispononi*).

f - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

g - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

gj - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

h - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

i- Formulari i vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike sipas linkut <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/104-formularin-ivetedeklarimit-per-garantimin-e-integritetit-te-personave-qe-zgjidhen-emerohen-ose-ushtrojne-funksione-publike>

Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara.

Mosparaqitja e dokumentacionit përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive duhet të bëhet brenda datës: 25.09.2026

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **05.10.2026**, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga njëësia e burimeve njerëzore të KMD-së, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët që nuk janë kualifikuar paraqesin ankesë me shkrim pranë Njesisë përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afateve të ankimimit

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligji nr. 214/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2021 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të protokolleve shtesë të saj;
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b - Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve). Njesia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në (KPP) për rezultatin e pikëve brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimi në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive, për:

- datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, duke filluar nga data 05.10.2026.

Njesia Përgjegjëse